



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS**

---

**Njoftim për shtyp**

**Mbi takimin e 8 të Nen-Komitetit BE-Shqipëri**

**“Për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”**

Në datë 26 Maj 2016 në Tiranë u zhvilluar takimi 8 i Nen-Komitetit BE-Shqipëri “ **Për tregun e brendshëm dhe konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit**”, i cili është një proces i përvitshëm raportimi dhe diskutimi midis Autoritetit të Konkurrencës dhe përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Konkurrencës së Komisionit Europian. Bazuar në një raport të hollësishëm të aktivitetit vjetor të institucionit të konkurrencës, mbikëqyrësit europianë të konkurrencës vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës, rekomandimet e dhëna për institucionet qëndrore e ato rregullatorë, si dhe për përafrimin e legjislacionit.

Nëpërmjet diskutimit, u mundësua konfirmimi i instrumentave të përdorura nga Autoriteti i Konkurrencës si të duhurat dhe të balancuarat në ambjentin ekonomik dhe institucional shqiptar. Më konkretisht, u vlerësua procesi dinamik i institucionit të konkurrencës për përafrimin e legjislacionit shqiptar të konkurrencës me atë të së drejtës europiane, qëndrimi proaktiv dhe bashkëpunues i Autoritetit për vlerësimin e konkurrencës, si dhe detyrimin e Qeverisë për të zbatuar rekomandimet e Autoritetit, si një instrument që i sjell të ardhura ekonomisë shqiptare.

Përfaqësuesit e DG Competition shprehën vlerësimet dhe konsideratat për punën dhe aktivitetin e institucionit, duke inkurajuar ndërhyrjet në tregje në mbrojtje të konkurrencës së lirë. U vlerësua puna e institucionit për sa i përket ndërhyrjeve në sektorët e tregut, rastet e vlerësimit dhe shqyrtimit të ankesave, bashkëpunimi kombëtar dhe ai ndërkombëtar i institucionit, kapacitetet administrative të stafit, etj.